

BASHKIA VAU DEJËS
NJOFTIM FITUESI

Autoriteti i Dhënies me Qira: Bashkia Vau Dejës njofton se në konkurrimin Publik të zhvilluar me datën 12.02.2024, ora 09:30, publikimi i të cilit është bërë me datën 29.01.2024 në Buletinin e Prokurimeve Publike nr.4, me objekt dhënie me qira:

Fillimi i procedurave për dhënie me qira per 10 (dhjetë) vite, me anë të konkurrimit publik për sipërfaqen në total 31.03 ha e ndarë në 5 lote, konkretisht LOTI II me sipërfaqe prej 19,485336 ha, e shtrirë në pasurinë nr 738, zk 3769, në fshatin Vig, “Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogjenerator dhe fotovoltaik(stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj)”, sipas Udhëzimit nr.1, datë 9.6.2016, “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik”.

Vlera fillestare:

Çmimi dysHEME i fillimit të konkurrimit është 176.000 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë/ha në vit për sipërfaqe të llojit “Livadh(Kullote)” dhe për 19,485336 ha është 3.429.419,2 (tre milion e katërqind e njëzet e nëntë mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë presje dy)lekë në vit për sipërfaqe të llojit “Livadh(Kullote)”, e përlllogaritur kjo sipas VKM-së nr. 559, datë 29.7.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”, dhe sipas Raportit mbi Studimin Tekniko-Ekonomik, përgatitur nga specialistët e fushës.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurën përkatëse të konkurrimit publik këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.Subjekti fizik “FORTIS ENERGY AND CONSTRUCTION”shpk numri i NIPT-it M11821012G

Oferta e paraqitur për dhënien me qira të sipërfaqes prej 19,485336 ha e shtrirë në pasurinë nr 738, LOTI II, “Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogjenerator dhe fotovoltaik(stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj)”, me afat përdorimi(qiraje) 10 vite është

prej 3.507.360,48 (tre milion e pesëqind e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë presje dyzet e tetë)lekë në vit pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. S'ka të skualifikuar
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Duke ju referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë:

1. Subjektin “FORTIS ENERGY AND CONSTRUCTION”shpk

Adresa: Tiranë, Njësia Administrative Nr 2, Rruga Abdi Toptani, Qendra Tregtare Torre Drin, K. 10, Ap.105, se oferta e paraqitur, për sipërfaqen prej 19,485336 ha , e shtrirë në pasurië nr 738, zk 3769, në fshatin Vig, “Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogenerator dhe fotovoltai(stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj)”, me afat përdorimi (qiraje) 10 vite, me oferte prej 3.507.360,48 (tre milion e pesëqind e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë presje dyzet e tetë)lekë në vit pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht jeni të lutur të paraqisni pranë Bashkisë Vau Dejës, me adresë: Rruga Qafa e Gurit, Vau Dejës dhe referencë kontakti zyrën e sektorit të Prokurimeve Publike, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, sic parashikohet në dokumentat e konkurimit publik, brenda 10(dhjetë) ditëve nga dita e marjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqen nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siigurimi i ofetës suaj, sic parashikohet në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 14.02.2024